

Këshillat tradicionale që vlimi i ujit të zgjasë 10 minuta është kryesisht për efekt sigurie pasi mikrobet fillojnë të eliminohen në temperaturat mbi 60°C, por gjithsesi arritja e vlimit tregon që është arritur temperaturë deri 100°C.

Tabela e mëposhtme paraqet kohën e inaktivimit të disa mikroorganizmave në temperatura të ndryshme.

Organizmi	Temperatura e ujit (°C)	Koha e inaktivimit (sekonda)
Baktere		
Escherichia coli	65	<2
	72	0.4
Enterococcus faecalis	65	7-19
Salmonella spp	72	0.1
Shigella sonnei	65	3
Vibrio cholerae	55	22.5
Viruse		
Hepatiti A	65	120
	75	30
	80	5
	85	<30
Virusi i polios	72	30
	95	15
Parazitë		
Giardia (Lamblija)	56	600
	70	90

Të dhënat e kësaj table, na tregojnë edhe njëherë se metoda e dezinfektimit të ujit duke e vluar atë, është një ndër metodat më efikase e cila zbatohet lehtësisht në kushtet e shtëpisë.

Pasi uji ka arritur pikën e vlimit, ai duhet të largohet nga zjarri dhe të ftohet gradualisht natyrshëm, duke mos shtuar akull në të, dhe të mbrohet më pas nga ndonjë ndotje e mundëshme gjatë ruajtjes së tij.

Frutat, perimet dhe çdo ushqim tjetër që nuk do të gatuhet duhet të lahen me ujë të pastër e të sigurtë, në të kundërt duhet të përdoret ujë i vluar (e më pas i ftohur).


Në të njëjtën mënyrë duhet të vepohet kur prodhohet akull, në mënyrë që ky i fundit të jetë sa më i sigurtë.




NDOTJA MIKROBIKE E UJIT


SI TA ELIMINOJMË ATË NË KUSHTET E SHTËPISË?




 **Shumë prej nesh nuk mendojnë rreth ujit që pijmë. Hapim rubinetin, mbushim gotën dhe e pijmë.**

 **Por, sa ujë kemi nevojë të pimë çdo ditë?**

 **A është i sigurtë uji që pimë, apo uji në shishe është më i sigurtë?**

 **Çfarë mund të bëni nëse uji i rrjetit ndotet në një moment të caktuar?**



Uji është një nevojë themelore e njerëzimit. Çdo person ka nevojë për 20 deri 50 litra ujë të pastër e të sigurtë për pirje, gatim dhe pastrim. Kjo sasi e konsiderueshme uji të pastër e të sigurtë është një ndër kushtet parësore për një jetë të shëndetshme, por sëmundjet e transmetuara nga uji mbeten ende shkaku kryesor i vdekjeve në shumë vende të botës, veçanërisht tek fëmijët.


Ndotja e ujit mund të ndodhë tek burimi i tij, si në sipërfaqe ashtu edhe nën tokë. Uji ka sërish mundësi të ndotet kur ndodhet në tubacionet e shpërndarjes së tij. Cilësia e ujit të pijshëm vihet në mëdyshje nëse tubat nuk janë totalisht të mbrojtur nga ndotësit dhe kur uji i pijshëm përzihet me ujërat e zeza si pasojë e dëmtimeve në rrjet.





Shëndeti mund të rrezikohet kur baktere të dëmshme, viruse dhe parazitë ndotin ujin e pijshëm që nga burimi e deri tek momenti i përdorimit të tij. Gjithashtu, ruajtja e ujit në kushte johigjienike gjatë transportit ose brenda në shtëpi mund të shkaktojë ndotjen e tij edhe pse fillimisht ka qenë i pastër dhe i sigurtë.

Prania e ndotësve në ujë mund të çojë në efekte shëndetësore të pakëndshme të cilat përfshijnë sëmundjet gastrointestinale apo probleme të tjera në organizëm. Diarrea, përfshirë kolerën, Tifo dhe Dizanteria janë ndër sëmundjet më të shpeshta të shkaktuara nga uji i ndotur.

Ka disa rrethana kur është e nevojshme të trajtohet uji përpara përdorimit në mënyrë që të largohen ose inaktivohen ndotësit mikrobikë. Këto përfshijnë:

 Dështim i masave të kontrollit, përfshirë këtu mungesën e dezinfektimit në mënyrë të saktë dhe ruajtjen dhe transportin në mënyrë jo të sigurtë;

 Emergjencia dhe fatkeqësi natyrore që çojnë në kushte higjienike dhe mbrojtje të burimeve të ujit të papërshtatshme;

 Pasiguri e cilësisë së ujit të burimeve gjatë udhëtimeve.

Një nga metodat më klasike dhe shumë efektive e dezinfektimit të ujit është ngrohja e tij deri në vlim (100°C). Me anë të kësaj metode arrihet, me një proces të vetëm, eliminimi ose inaktivimi i ndotësve

mikrobikë përgjegjës për shkaktimin e sëmundjeve të lidhura me zorrët duke mos ndikuar tek shija e ujit.

